



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODER  
NJESIA E PROKURIMEVE

**Procesverbal për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote me objekt “Blerje materiale per rritjen dhe modernizimin e ndriçimit”**

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*

*2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”*

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

**Së pari**, kemi të bëjmë me të njëjtën lloj mallrash, pra me natyrë të njëjtë, që në thelb i përkasin të njëjtës kategori dhe janë në funksion të njëra tjetrës dhe nuk mund të instalohen të ndara.

**Së dyti**, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Shkoder, ku përfshihen një nga objektet kryesore dhe të rëndësishme të veprimtarisë së saj, mirëmbajtjen dhe vendosjen e ndriçimit publik në të gjithë territorin e Bashkisë Shkoder. Në funksion të kësaj veprimtarie AK-ja kërkon që furnizimet të jenë të mundura në cdo moment kur materialet e ndriçimit janë të nevojshme dhe pa vonesa në furnizimin e tyre, krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa operatorë ekonomikë, ku AK-së do ti duhet të presë furnizimin e njërit mall nga njëri operator dhe furnizimin e mallit tjetër nga operatori tjetër, sipas loteve, ofron pasiguri, konfuzion, kosto shtesë, vonesa duke vështirësuar në ushtrimin e detyrave të AK-së apo mosrealizim të punëve sipas objektivave.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.